

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR “Bdex Labour Supply Services” shpk,

Në Tiranë, sot më datë 21.07.2021, une i poshtëshënuari:

Md Hasanuzzaman, i datëlindjes 25.09.1983, lindur ne Kushtia, Bangladesh , identifikuar me dokument identifikimi:pasaporte me numër personal ,AE 0072461, me cilësinë e “ortakut themelues”deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, “**Bdex Labour Supply Services” shpk,**

Neni 1 Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin “**Bdex Labour Supply Services” shpk**, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3 Selia

Shoqëria “**Bdex Labour Supply Services” shpk** e ka seline në adresë:”Njesia Bashkiake Nr 9 ,Ruga Don Bosko,ndertese private Nr 52 ,Tiranë” dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 4 Objekti i veprimtarisë

Objekti i ushtrimit të veprimtarise per shoqërine “**Bdex Labour Supply Services” shpk** është:Zyre punesimi,ndermjetesim mes punemarresve dhe pundhenesve ne republiken e Shqiperise dhe jashte saj.

Neni 5 Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.



Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100,000 lekë, i ndarë në 1(nje) kuote e cila zotërohet si më poshtë:

Md Hasanuzzaman, i datëlindjes 25.09.1983, lindur ne Kushtia,Bangladesh , identifikuar me dokument identifikimi:pasaporte me numër personal ,AE 007246, e cila përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;



g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë “**Bdex Labour Supply Services**” shpk është:

Md Hasanuzzaman, i datëlindjes 25.09.1983, lindur ne Kushtia,Bangladesh , identifikuar me dokument identifikimi:pasaporte me numër personal ,AE 0072461,

Administratori i shoqërisë është i emeruar për një afat 5(pesë) vjeçar.Data e emerimit të tij përkon me datën e themelimit të shoqërisë që është data 21.07.2021.

Neni 10

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nën per nen nga ortakët themelues të shoqërisë tregtare “**Bdex Labour Supply Services**” shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

ORTAKU THEMELUES
Md Hasanuzzaman